



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 479/ Prot.
101

Datë 7.4.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lezhë

Drejtuar: Z. Fran FRROKAJ
Kryetar
Bashkia Lezhë

Për dijëni: Operatori ekonomik UTS-01 shpk ✓
Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 7, Rr. "Nikolla Jorga", Nd. 7, H. 7, Ap. 42,
Tiranë

I nderuar Z. Frrokaj,

Në vijim të shkresës Tuaj, Nr. 2601 Prot., datë 04.04.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 479 Prot., datë 05.04.2017, me lëndë: "Kërkesë për kontrollin e përputhshmërisë së draftit të PPV-së Bashkisë Lezhë", AKPT ka kryer kontrollin e përputhshmërisë sipas legjislacionit të planifikimit dhe atij sektorial të materialit në CD bashkëlidhur shkresës Tuaj.

Sipas VKM Nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit": "AKPT-ja kryen shqyrtimin e përputhshmërisë së dokumentacionit brenda 15 ditëve nga data e botimit dhe e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë."

Dokumentacioni i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë, është e nevojshme të botohet i plotë në Regjistrin e Integruar të Territorit, ndërkohë që materiali i dorëzuar në rrugë shkresore është i mangët në informacion, dhe duhet të plotësohet në respektim të përmbajtjes së PPV-së sipas Rregullores së Planifikimit.

Nga dokumentacioni i dorëzuar:

1. Dokumenti "Pasaportat Lezha", ku jepen treguesit e zhvillimit sipas njësive stukturore, duhet të shoqërohet me të paktën një hartë ku paraqiten njësitet stukturore shoqëruar me kodet përkatëse, në mënyrë që të shqyrtohet.
2. Mbi dokumentin "P-U-08 PERDORIMI I TOKES", jepen komentet paraprake si vijon:

- a. Njësitë e propozuara me përdorim “S – shërbim”, në lindje të qytetit të Shëngjinit dhe në perëndim të Liqenit të Kënallës, duhet të reduktohen në shtrirje, duke respektuar vijën ekzistuese të urbanizimit, e cila shtrihet aktualisht deri në brigjet e trupave ujorë që gjenden në këtë territor. Në respektim të Ligjit Nr. 112/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, infrastruktura rrugore e propozuar për t’i shërbyer zonës urbane ekzistuese, duhet të respektojë largësinë nga brigjet, ndërkohë që po ashtu zgjerimi urban nuk duhet të prekë asnjë nga këto brigje.
- b. Njësia e propozuar me përdorim “S – shërbim”, që prek Lagunën e Merxhanit, Zonë e Përdorimit Tradicional pjesë e Zonës së Mbrojtur Kune-Vain-Tale, dhe njëkohësisht trupin ujor të lagunës, duhet të rishikohet, për të respektuar legjislacionin sektorial përkatës dhe të sipërcituar, duke reflektuar përdorimin në përputhje, “N – natyrë” dhe “U-Ujëra”.
- c. Njësitë në veri të portit të Shëngjinit, mbi rrugën ekzistuese, të shtrira paralel me bregdetin, në respektim të PINS-Bregdetit, duhet t’i përgjigjen Sistemit Natyror, ku primar është konservimi i natyrës. Orientimi për shërbime dhe zhvillim territorial duhet të jetë dytësor, duke i kaluar për detajim të mëvonshëm PDZRK-së përkatës.
- d. Njësitë e propozuara me përdorim “S – shërbim”, mes bregdetit dhe Tales, duhet t’i përgjigjen Sistemit Natyror, në respektim të PINS-Bregdetit. Orientimi për shërbime dhe zhvillim territorial duhet të jetë dytësor, duke i kaluar për detajim të mëvonshëm PDZRK-së përkatës.
- e. Rikujtojmë që Brezi Bregdetar është Zonë e Rëndësisë Kombëtare, pjesët e orientuara për zhvillim territorial të të cilit duhet t’i nënshtrohen hartimit të Planeve të Detajuara të Zonave të Rëndësisë Kombëtare.

Me botimin në regjistër e dërgimin e PPV-së së plotë për Bashkinë Lezhë, dhe reflektimin së paku të çështjeve të listuara më sipër, AKPT do të angazhohet për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë, në mënyrë që të vijohet me miratimin e PPV-së në Këshillin Bashkiak, dhe Këshillin Kombëtar të Territorit.

Me respekt,

Adelina GRECA



DREJTORE E PËRGJITHSHME

Konceptoi, punoi: F. Mali
 Datë: 07.04.2017
 Nr. Kopje: 3